

Prof. Dr. Sulltane KOJÇINI-UKAJ

PLANI I ÇETNIKËVE PËR SPASTRIMIN ETNIK TË TROJEVE SHQIPTARE

Qarkorja e komandës çetnike, të quajtur Komanda Malore, mbi politikën gjenocidale ndaj shqiptarëve dhe popujve të tjerë joserbë në trevat e ish-Jugosllavisë është hartuar më 20 dhjetor 1941. Dokumenti që po publikohet për herë të parë është një plan në formë qarkoreje e trakti dhe është nënshkruar nga Drazha Mihajloviq – komandant, gjeneral i ushtrisë çetnike, dhe Pavle Gjurishiq, kapiten i këmbësorisë. Kjo qarkore i dërgohet për shqyrtim dhe zbatim Gjorgje Laziqit, komandant i çetnikëve të Limit. Dokumenti gjendet në Arkivin Shtetëror të Shqipërisë në Tiranë (Fondi 556 viti 1943, dt. 17 fl. 67), i përkthyer prej serbishtes dhe ka dy faqe të ngjeshura kompjuteri. Dokumenti përmban instruksionet, objektivat, veprimet dhe përfundimet që ushtria çetnike duhej të zbatonte në Kosovë, Sanxhak, Bosnjë, Slloveni, Kroaci, Bullgari dhe në Shqipëri. Duke analizuar këtë dokument, pa mëdyshje vijmë në konstatim se hartimi i një plani-qarkoreje të tillë ishte vazhdimësi e një politike djallëzore serbe, e hartuar shumë vite më parë në elaboratet e Akademisë Serbe për zhdukjen e shqiptarëve, duke u futur edhe brenda kufijve të shtetit shqiptar. Objektivat e këtij plani përputhen në shumë segmente me politikën gjenocidale serbe që e zbatoi në Jugosllavi diktatori Slobodan Milosheviq që nga viti 1981, dhe fitohet përshtypja se politika serbe ka shfrytëzuar këtë plan çetnik për zbatimin e politikës së saj gjenocidale. Ky plan nuk ishte rastësi për kohën. Atij i paraprinë edhe shumë elaborate, programe e marrëveshje ndërshtetërore, që Serbia hartoi për zhdukjen e popullit shqiptar dhe popujve të tjerë joserbë. E shohim me interes që me këtë rast t'ua rikujtojmë lexuesve disa nga planet, elaboratet dhe marrëveshjet ndërshtetërore serbe për zhdukjen e shqiptarëve.

Marrëveshja sekrete ndërmjet Serbisë dhe Austro-Hungarisë më 28.VI.1881; Marrëveshja ndërshtetërore më 1897 ndërmjet Austro-

Hungarisë dhe Rosisë; Marrëveshja e Jugosllavisë dhe Turqisë e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve; Marrëveshja “xhentëlmene” më 1953.

Veç këtyre marrëveshjeve, Serbia asnjëherë nuk pushoi së vepruari edhe në hartimin e shumë programeve – elaboreteve për shfarosjen e shqiptarëve. Në këtë aspekt Serbia nuk ka të ndalur as në ditët e sotme. T’ia rikujtojmë lexuesit vetëm Ligjin për ndarjen e banesave dhe për kolonizimin e Kosovës të vitit 1995, me ç’rast shumë shqiptarë me dhunë u larguan nga banesat e tyre legjitime për t’u akomoduar në to serbët e malazeztë.

Programet dhe elaboretet e hartuar serbe për shfarosjen e popullit shqiptarë janë: “Naçertania” më 1844, Programi i depërtimit në det më 1881, Programi i likuidimit të shqiptarëve më 1920, Elaborati i Çubriloviqit më 1937, Programi i Ivo Andriqit më 1939, Programi i Moleviciqit më 1941, Programi i Drazha Mihajloviqit më 1942, Elaborati i Çubriloviqit më 1944 dhe 1945, Programi i likuidimit të shqiptarëve më 1950, Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave më 1986.

Qarkorja e Komandës çetnike parashihte zgjerimin e Jugosllavisë në toka të shteteve fqinje, veçmas në Veriun e Shqipërisë, Triesten, Goricën dhe një pjesë të Bullgarisë dhe brenda saj krijimin e Serbisë së madhe, siç thuhet *“të kullueme kombëtare”*, që do të përfshinte, veç kufijve të Serbisë edhe Malin e Zi, Bosnjë- Hercegovinën, Sremin, Banatin dhe Baçkën në Vojvodinë. Për realizimin e këtij synimi, sipas këtij dokumenti, duhej bërë spastrimin e të gjithë atyre, siç thuhet, *“që nuk janë prej origjinës sonë”*, nga Shkodra, Sanxhaku, Bosnja e Kroacia. Hartuesit e këtij plani-qarkoreje parashihnin që vendin meritohet në këtë Jugosllavi të zgjeruar ta kishte Serbia. Në këtë plan pasqyrohen edhe fërkimet ndërmjet serbëve dhe malazezëve. Për këtë jepen udhëzime që të punohet sa më shumë me malazezë dhe, siç thuhet, në dokument *“të rekrutohen personat me ndikim në Mal të Zi, të cilët do të zhvillojnë propagandë të përshtatshme”*.

Në vazhdim, për hir të autenticitetit, po sjellim dokumentin e plotë, ashtu siç është përkthyer nga gjuha serbe, pa ndërhyrje gjuhësore, veç emrave që janë shpjeguar brenda kllapave.

PLANI KRIMINEL SERB KUNDRA SHQIPTARËVE

Dokumenti i Mihajloviqit gjetun tash së afërmë mbi një kryengritës serb.

Dokumenti

Komanda e Punëve çetnike të ushtrisë jugosllave – Komanda Malore.
Nr. 370 i Protokolit Sekret Data 20 Dhjetor 1941.

QARKORE

Majorit epror Jorgji Lasiç (Gjorgje Laziq) komandant i punëve çetnike të ushtrisë jugosllave në Mal të Zi dhe kapitenit z. Pavlo Gjurishiç (Pavle Gjurishiç), komandant i çetnikëve të Limes. (Limit).

INSTRUKSIONE

Qeveria e jonë ndodhet edhe sot e kësaj ditë në luftë kundra armiqve tonë ma të mëdhenj: gjermanve dhe italianëve. Përjashta kufijve t'Atdheut ndodhet Mbreti i ynë dhe Qeveria e jonë, që punojnë për shkrimin e popullit tonë me anën e diplomacisë dhe të armëve kundra armiqve t'onë. Në këtë luftë vigane nuk jemi vetëm, por me ne janë shtetet e mëdhenj: Amerika, Anglia, Rusija, Kina dhe kombet e tjera demokratike.

Fitorja e jonë është e sigurtë. Ushtria e jonë, e cila në prillin e kaluem u gënjye, akoma nuk është mbarue, akoma lufta vazhdon dhe prandaj nuk ka pasun akoma as të mundun e as fitues. Çetnikët e ushtrisë s'onë u a kanë zgjatun akoma jetën këtyre fuqive për të mirën e Kombit.

OBJEKTIVAT T'ONA

- 1) Lufta për shkrimin e krejt tokës jugosllave nën udhëheqjen e Mbretit t'onë Pjetër i II-të.
- 2) T'a zmadhojmë Jugosllavinë dhe mbrenda saj t'a bajmë ma të madhe Serbinë, të kullueme kombëtare, me kufijtë e Serbisë, të Malit të Zi, të Bosnjës Hercegovinës dhe të Shqipërisë së Veriut duke përmbledhur edhe Shkodrën;
- 3) Lufta për shkrimin e të gjithë atyre që akoma ndodhën nën sundimin italian, gjerman e shqiptar! Trieshten, Gorcianën (Goricën) Istren dhe Korishken, sikurse Bullgarinë dhe Shqipërinë e Veriut, duke përmbledhur Shkodrën;
- 4) Dëbimi i të gjithë popullsive të këtyre tokave që s'janë prej origjinës s'onë;
- 5) Me i zhdruk ndryshimet racore midis serbëve e malazezëve, sikurse ato midis serbëve e sllovenve, duke i spastrue myslimanët prej Sanxhakut dhe Bosnjën prej kroatëve dhe myslimanëve;
- 6) Me i gjykue të gjithë ustashët dhe myslimanët të cilët në të shkuemen e kanë fye kombin serb;
- 7) Me i gjykue të gjithë ata që janë fajtorë për katastrofën tonë të prillit;

- 8) Do të kthehen nëpër vendet e tyre të gjithë malazezët që do të jenë provue si nàcionalist të vërtetë;
- 9) T'emnojmë një Qeveri që do të interesohet rreth Kombit, i cili ka për me e zgjedh vetë;
- 10) Dëshirat janë të mëdhaja, gja për të cilën ka marrë përpjesëtimet e veta të mëdhaja dhe prandaj duhet të luftojmë fort për të fitue atë që duem. Bani gjithë që mundet edhe të gjithë banorët e Malit të Zi t'a ndihmojnë fitoren t'onë sepse faktet po zhvillohen me shpejti dhe pra nuk duhet të na befasojnë.

SI DUHET TË PUNOJMË E TË LUFTOJMË TASH

- 1) Disa njësjna çetnikësh nga lumi `Lima (Lim) duhet të drejtohen kah Belo Pole – Senicë për t'i pastrue myslimanët dhe shqiptarët. Këto njësjna duhet të bashkëpunojnë midis tyne ndër malet e Javoriçinit (Javorit) dhe Golishinit;(Kollashinit)
- 2) Reparte të tjera duhet të punojnë në drejtim përtej Gjakorit (Çakorrit) për në Mokna, malet e rajonit të Pejës, për të spastrue ambientin shqiptarë dhe të takohen me elemente të favorshme në zonën e Pejës. Këto reparte duhet t'i pëmbahen urdhënave të çetave të Kopaonikut.
- 3) Një repart tjetër duhet të punoi nga Nikshiqi drejt Adriatikut për shlirimin e Raguzës (Dubrovnikut). Ky repart duhet të punoi me kolonën në të majt të Dançijeviqit, që të veproji përtej Mostarit;
- 4) Reparte të tjera duhet të përgatiten për marrjen e Shkodrës. Duhet ruajtur që në tokat e Malit të Zi të mos hyjnë elemente shqiptare.

INSTRUKSIONE

Me myslimanët dhe me shqiptarët duhet veprue ashtu sikurse këta kanë veprue me popullin tonë; po kështu duhet të themi për kroatët që tani ndodhën nën pushtimin italian, domethënë t'ua kthejnë atë që kanë bamë kundra serbëve.

ORGANIZIMI

Si komandant i çetnikëve të Malit të Zi emnohet majori Jorgj Lasiç (Gjorgje Laziq). Detyra e tij vepruese, do të jetë të mbledhë lajme rreth ngjarjeve, duke mbledh gjithashtu ushqime e gjithçka që nevojitet për vazhdimin e luftës. Komanda e çetnikëve të Malit të Zi do të quhet "Komanda e Punëve të Çetnikëve t'Ushtrisë Jugosllave – Komanda Malore nr. 15". Si komandant i çetnikëve të Limës dhe të rretheve,

emnojmë kapitenin e kl. I-rë Pavle Gjurishiqin. Eventualisht komanda të tjera për Malin e Zi dhe për tokat e Limes do të emnohet prej dy komandantëve të emnuem më sipër.

Lufta e jonë quhet luftë e kombit.

Lufta duhet të ketë emrin luftë kombëtare. Organizimi i saj duhet bamë si mbas porosive të dhanuna prej nesh – kapitenit Pavle Gjurishiq. Qeveria mbetet ajo që ishte në datën 27 mars 1941. Të dy komandantët e treguem ma sipër (të lartë përmendur S.U) do t'i japin reparteve mvartës emnat që do t'u pëlqejnë, por duke mos harrue të përmendin numrin 15. Ashtë nevoja me i mbledhë sa ma parë që të jetë e mundun armët dhe municionet përkatëse, ushqimet dhe t'i vendosin ndër magazinë për t'i mbajtun gati. Ka krahina të Malit të Zi ku gjinden armët dhe sendet e tjera të nevojshme, nga ana tjetër ka edhe krahina që nuk kanë, prandaj duhet shpërndamë me drejtësi dhe në kohë. Për ndihma dhe për instruksione duhet t'i drejtoheni deputetit Rasviç.

PËRFUNDIME

Komanda Eprore duhet të ketë radio stacionin transmetues që do të transmetojë lajme sipas shifrarit në zotënim të kapitenit Pavle Gjurishiq. Duhet përgatitur aerodrome për të pritun natën ushqime dhe gjana të tjera të nevojshme me aeroplan. Komanda Eprore duhet ta ketë selinë e vet në aerodromin kryesor. Duhet me sigurie një rrugë që prej Adriatikut të shpjerë në Mal të Zi, kështu që të sigurohen furnizime nga deti. Duhet me pas kontakte me njëfarë Dangiç prej Bosnje, nëpërmjet të Gatska Beliçit. Për instruksione prej Serbije, nëpërmjet Komandës së Limës. Komanda Eprore duhet t'i rekrutojë të gjithë personat ma në sy të Malit të Zi të cilët do të zhvillojnë propagandë të përshtatshme. T'u përbahemi porosive të dhanuna prej nesh Kapitenit Gjurishiq. Duhet punue me zgjuarsi dhe pa gjakderdhje të panevojshme. U dërgoj të gjithë Komandantëve e gregarëve përshëndetje t'eme durimtare.

Rroftë Mbreti Pjetër II-të dhe Rroftë kombi i ynë.

Komandant: Gjeneral Dragisha Mihajlliviq, Kapiten i kl. I-rë i Kambëisorisë Pavle Gjurishiq.

